

Ekskluzive

Ekskluzive | Fotoja me pistoletë e “tradhton” 23-vjeçarin në Prizren – Policia ia bastis shtëpinë, përfundon në ndalim



Sinjali.com

14 Gusht 2026 07:49



Një fotografi e siguruar nga një person anonim ka çuar Policinë të një 23-vjeçar nga Prizreni, i cili dyshohet se ka përdorur armë dhe e ka mbajtur atë pa autorizim, mëson Sinjali.

Burimet e Sinjalit bëjnë të ditur se i dyshuari është **Ermir Kurtaj**, 23 vjeçar, i cili është identifikuar pasi Policia ka pranuar informacion dhe materiale që dyshohet se e implikojnë në rast.

Ngjarja dyshohet se ka ndodhur më 12 gusht, rreth orës 15:45, në rrugën “Mati” në Prizren.

Sipas informacioneve që ka siguruar Sinjali, në njërën prej fotografive i dyshuari shihet duke mbajtur një pistoletë në dorë, ndërsa në një tjetër arma shihet e drejtuar nga qielli, duke ngritur dyshimet se ai kishte shtënë me të.

Pas pranimit të informatës, Policia ka arritur ta identifikojë të dyshuarin dhe më pas është realizuar bastisje.

Gjatë veprimeve policore dhe në bashkëpunim me të dyshuarin është siguruar edhe pistoletë, e cila është sekuestruar nga Njësiti i Forenzikës.

Për rastin është njoftuar Prokurori kujdestar nga Departamenti për Krime të Përgjithshme, i cili ka urdhëruar inicimin e rastit për “Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” dhe “Përdorim të armës apo mjetit të rrezikshëm”.

Me vendim të Prokurorit, Kurtaj është ndaluar për 48 orë.

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitnes
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera